



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 700/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NPSH “Afa Ing”- Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: “PBC” SHPK, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve” me nr. të prokurimit: 613-18-3055-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-Lipjan, më datë: 17.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik NPSH “Afa Ing”- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve” me nr. të prokurimit: 613-18-3055-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK-Lipjan.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve” me nr. të prokurimit: 613-18-3055-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK-Lipjan.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NPSH “Afa Ing”- Suharekë, refuzohet si e pa bazuar të njëjtit operator ekonomik i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 11.05.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 15.05.2018, ku kanë marrë pjesë dy (2) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: NPSH “Afa Ing”- Suharekë, si tenderues i eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 12.11.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: NPSH “Afa Ing”- Suharekë, me dt: 19.11.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 21.11.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: NPSH “Afa Ing”- Suharekë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: NPSH “Afa Ing”- Suharekë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 30 Nëntor 2018, me nr. 700/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve” me nr. të prokurimit: 613-18-3055-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK-Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 56.3, 59, 60 dhe 116.6, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.12.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 10.12.2018, sqaron se Autoriteti Kontraktues- “Komuna Lipjan”, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar Procedurë të hapur /kuotimit të çmimit, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të vogël, operatori ekonomik ankues: NPSH “Afa Ing” – Suharekë, ka parashtruar ankesë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas rivlerësimit të ofertave, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të potencuar në letër standarde ku AK /Komuna Lipjan, ka potencuar: *“Duke u bazuar në vendimin e OSHP-së oferta juaj është eliminuar sepse keni bashkangjitur katalogë që nuk janë në përputhje me specifikimet teknike”*.

- Kundër të njëjtit arsyetim parashtruesi i ankesës më datën 19.11.2018, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP, përderisa AK/ Komuna Lipjan, më datën 21.11.2018, nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën si të pa bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit tanimë janë nxjerr vendim me nr. 229/18, i datës 10.07.2018, dhe me nr. 370/18, i datës 23.08.2018, rrjedhimisht janë shqyrtuar dhe janë trajtuar pretendimet ankimore të OE, atëherë ankues, tani i rekomanduar për dhënie, “PBC”shpk, të cilat kryesisht kanë qenë kundrejt operatorit ekonomik tani ankues NPSH “Afa Ing”- Suharekë, për të cilat paneli shqyrtues përmes vendimeve të lartë përshkruar ka gjykuar dhe ofertën e parashtruesit të ankesës e ka trajtuar si të pa përgjegjshme. Prandaj ri trajtimi i pretendimeve ankimore të gjykuara nga paneli shqyrtues, paraqet mos respektim të nenit 16, të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017.

Konkretisht përmes arsyetimit të vendimit me nr. 229/18, është konstatuar se parashtruesi tani i ankesës OE NPSH “Afa Ing”, nuk e ka ofruar katalogun siç është kërkuar, pasi që në dosje të tenderit është kërkuar në specifikat e detyrueshme teknike që televizioni për shfaqjen e radhëve të jetë 49 inç apo 125 cm, por ka ofruar me televizion me madhësi prej 42 inç, e që është dukshëm më i vogël se kërkesa e AK-s. Për më tepër përmes arsyetimit të vendimit me nr. 370/18, paneli shqyrtues ka konstatuar se AK/Komuna Lipjan, nuk i ka respektuar nenet 59 dhe 60, të LPP-s, në kuptim të asaj që është rekomanduar përsëri operatori ekonomik i cili nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues NPSH “Afa Ing”- Suharekë, të refuzohet si e pa bazuar dhe t’i lejohet AK, të procedoj tutje me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori ekonomik ankues: NPSH "Afa Ing"- Suharekë, me datë: 12.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 17.12.2018, ku kanë qenë prezent kryetari i panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbal i mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Morina deklaroj: Te nderuar paneli, duke u nisur nga akti përcjell shqyrtues konkludime nga ana jone si kompani Alfa Ing se është bere një lëshim gjate ekzaminimit te kriterave teknike profesionale te paraqitura dhe te kërkuara tek pjesa e njoftimit për kontrate dhe dosja e tenderit. Pozicioni i punës tek i cili AK pretendon se ka qene terkes tek dosja e tenderit, Mirëpo ne ju deponojmë faktet minimale të TV 49 ING. Për here te pare dhe te fundit është paraqitur tek paramasa dhe tek parallogarita, gjë qe ne e kemi vendosur çmimin tone dhe ne do ta furnizojmë dhe montojnë TV 49 inç ashtu siç e kemi dhënë çmimin ne paramane dhe parallogarit, ndërsa katalogu u prezantuar ne dosjen e tenderit prezanton vetëm Markën, Ndërsa madhësinë e keni të garantuar ne paramasa. I kërkoj panelit qe mbas dy here radhazi fitues te kësaj kontrate eliminohemi për një pretendim qe nuk është fare dhe nuk ekziston tek kërkesa minimale teknike profesionale, pra është shkelje e hapur tek neni 53. Si afarist te riye dhe inxhinier te profesionit tone jemi shumë te dëshpëruar me udhëheqjen e këtij aktiviteti të prokurimit. Kërkojmë qe lënda të kthehet ne Ri-vlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z.Bibaj deklaroj: Pretendimet kryesore ankimore kane të bëjnë kundër arsyetimit të eliminimit ku AK eliminimin e OE ankues e ka bazuar ne vendimin e OSHP-së, me arsyetimin se keni bashkangjitur katalogë qe nuk janë ne përputhje me specifikat teknike. Është e vërtet qe OSHP ka nxjerr dy vendime për AK- 229/18 është konstatuar se OE ne "Afa Ing", nuk e ka ofruar katalogun siç është kërkuar, pasi qe në dosjen e tenderit, përkatësisht ne specifikat teknike është kërkuar që TV të jetë 49 inç ndërsa OE –ankues e ka ofruar 42 inç. ky është konstatimi i vendimit të OSHP. Prandaj propozoj qe të mbetet ne fuqi vendimi i AK-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr vendim me nr. 229/18, i datës 10.07.2018, dhe me nr. 370/18, i datës 23.08.2018, ku janë shqyrtuar dhe janë trajtuar pretendimet ankimore të OE-së, atëherë ankues, tani i rekomanduar për dhënie, "PBC"shpk, të cilat kryesisht kanë qenë kundrejt operatorit ekonomik tani ankues NPSH "Afa Ing"- Suharekë, për të cilat paneli shqyrtues përmes vendimeve të lartpërmendura ka gjykuar dhe ofertën e parashtruesit të ankesës, e ka trajtuar si të pa përgjegjshme. Andaj ri trajtimi i pretendimeve ankimore të gjykuara nga paneli shqyrtues, paraqet mos respektim të nenit 16, të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017.

Paneli shqyrtues përmes arsyetimit të vendimit me nr. 229/18, ka konstatuar se parashtruesi tani i ankesës OE NPSH "Afa Ing", nuk e ka ofruar katalogun siç është kërkuar, pasi që në dosje të tenderit është kërkuar në specifikat e detyrueshme teknike që televizioni për shfaqjen e radhëve të jetë 49 inç apo 125 cm, por ka ofruar me televizion me madhësi prej 42 inç, e që është dukshëm më i vogël se kërkesa e AK-së. Për më tepër përmes arsyetimit të vendimit me nr. 370/18, paneli shqyrtues ka konstatuar se AK/Komuna Lipjan, nuk i ka respektuar nenet 59 dhe 60, të LPP-së, në kuptim të asaj që është rekomanduar përsëri operatori ekonomik i cili nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga AK –KK Lipjan, në pajtim me nenin 4 par. 1.26 të LPP-së, ku thuhet : "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Paneli shqyrtues duke u bazuar në fakte të prezantuara në dokumentacionin që kemi pasur në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, në këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në vendimet e mëparshëm të OSHP-së me Nr. PSH nr. 229/18 të datës 26.06.2018, dhe PSH nr. 370/18 të datës 22.08.2018, është vërtetuar që OE NPSH "Afa Ing"- Suharekë, nuk plotëson kërkesat në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe është pale pa interes në këtë aktivitet të prokurimit më saktësisht nuk e ka ofruar katalogun siç është kërkuar, tek specifikat e detyrueshme teknike që televizioni për shfaqjen e radhëve të jetë 49 inç apo 125 cm,

ndërsa OE ankues ka ofertuar me televizion me madhësi prej 42 inç, e që është dukshëm më i vogël se kërkesa e AK-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - KK-Lipjan

1x1 OE - NPSH "Afa Ing"- Suharekë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.